

te fjaloni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHMË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SE SHPETIT
AKADEMIA E SIGURISË

Nr. 20 Prot.

Tiranë më 24.01.2024

MIRALTOHET

REKTORI I AKADEMISË SË SIGURISË

Prof. Ilirjan MANDRO



I

AKADEMISË SË SIGURISË PËR VITIN 2024

I. VLERËSIMI I SITUATËS

Në vitin 2023, Akademia e Sigurisë ka punuar me përgjegjësi të plotë për implementimin e objektivave që lidhen me strategjinë e Qeverisë në fushën e Sigurisë Publike, të Ministrisë së Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi të plotë arsimor, për formimin, trajnimin dhe specializimin e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese.

Performanca e Akademisë së Sigurisë ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm edhe si rezultat i përmirësimit të akteve nënligjore, që burojnë dhe bëjnë të zbatueshëm ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në RSH” dhe dokumente të tjera me rëndësi strategjike për veprimtarinë e Akademisë së Sigurisë, si institucioni përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve e Policisë së Shtetit.

Objektivat dhe indikatorët e matshëm, të përcaktuara në programin e punës së Akademisë së Sigurisë për vitin 2023, janë realizuar. Këtë e tregojnë arritjet e Akademisë së Sigurisë në të gjitha fushat e shkollim / trajnimeve, konkretisht:

- Vlerësimi i Akademisë së Sigurisë me “Akreditimin Institucional”, cilësor;
- Akreditimi i programeve të studimit “Bachelor”;
- Vazhdimi i punës për realizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Akademië Arsimore Policore Italiane;
- Rishikimi dhe formatizimi i moduleve në Kolegjin Profesional të Formimit Policor me kërkesat dhe standartet e kornizave arsimore dhe përgatitja për akreditim;
- Rritjen e nivelit administrativ të disa strukturave e përkthyer kjo në rritje të pagave për disa funksione;
- Zhvillimi i mëtejshëm i kërkimit shkencor dhe botimeve në nivel edhe më të lartë për çështjet e policimit dhe sigurisë;
- Miratimi i një strukture akademike në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe të Policisë së Shtetit, pa shkurtime në personel.

Për vitin 2023, është realizuar pjesa takuese e Planit të Veprimit për realizimin e Prioriteteve të Ministrisë së Brendshme – 2023 dhe **Programit të Punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ku është përcaktuar si prioritet strategjik: “Rritja e cilësisë së arsimit policor”, nëpërmjet “Transformimit të Akademisë së Sigurisë”**. Për realizimin e tij është përcaktuar si Prioritet Specifick, “Transformimi i Akademisë së Sigurisë në zbatim të VKM nr. 881, datë 30.10.2019, “Për dhënien e statusin të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e të sigurisë publike, si organizimin e funksionimin e saj”, të ndryshuar. Janë realizuar objektivat, masat dhe aktivitetet e këtij prioriteti specifick.

Akte të prodhuara dhe të miratuara për vitin akademik 2023:

1. Urdhër i Ministrit të Brendshëm nr. 47, datë 14.04.2023, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”.Struktura e re e Akademisë së Sigurisë;
2. Statuti i Akademisë së Sigurisë, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr. 130, datë 10.03.2023;
3. Rregullojta e Akademisë së Sigurisë, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 77, datë 02.05.2023;
4. Rregulloret e njësjive kryesore dhe të strukturave të tjera vartëse të Akademisë së Sigurisë në përputhje me Statutin dhe strukturën e re;
5. Përskrimet e punës të funksioneve të personelit të strukturave të AS, miratuar me Vendim të Senatit Akademik;
6. Programi vjetor i trajnimeve të Policisë së Shtetit për vitin 2023, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr. 1477, datë 22.12.2022;
7. Programi vjetor i trajnimeve të Agjensive ligjzbatuese për vitin 2023, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nr.1514, datë 30.12.2022;
8. Hartimi i programit “Trajnimi i Detyrueshëm në Shërbim për Punonjësit e Policisë së Shtetit për gradat policore nga niveli zbatues deri tek grada “Drejtes i Parë”, për vitin 2023;
9. Hartimi i kurrikulës “Për kursin bazë të trajnimit të punonjësve të MZSH-së për fitimin e gradës Kryezjarrfikës”, miratuar me Vendim të Këshillit të Kolegjit Profesional të Formimit Policor me nr. 50/2 datë 20.01.2023;
10. Hartimi i kurrikulës, Programi i trajnimit “Hetimi i krimeve të lehta dhe veprimet operationale”, për strukturat e Agjensisë së Mbikqyrjes Policore;
11. Hartimi i programit mësimor “Për Njësinë Policore Detare” për strukturat e Policisë së Shtetit që do të zhvillojnë trajnimin pranë Qendrës së Trajnimeve të Rojes Bregdetare Shqiptare;
12. Hartimi i programit të trajnimit “Testimi Elektronik” dhe matricat me modalitetet përkatëse;
13. Hartimi i kurrikulës “Hetimi i Krimeve të Lehta”, për Policinë Ushatake;
14. Hartimi i kurrikulës “Për sinjalizimin, hetimin administrativ dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Policinë e Shtetit”;
15. Hartimi i kurrikulës “Për punonjësit e policisë për gradën Inspektor i Parë”;
16. Hartimi i kurrikulës “Për punonjësit e policisë për gradën Inspektor i Dytë”;
17. Hartimi i kurrikulës “Për punonjësit e Kufirit dhe Migracionit”;
18. Hartimi i kurrikulës “Për personelin civil që punon në strukturat e Policisë së Shtetit dhe për ndryshim emërtimi në punonjës policie me gradën Inspektor”;
19. Rishikimi i kurrikulës “Për formimin bazë të Policisë Bashkiake”.

Si rezultat i kësaj pune, gjatë vitit 2023, nga Akademia e Sigurisë u arrit:

- Në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, me përfundimin e vitit akademik 2022-2023, kanë ndjekur studimet 251 studentë të programit “Bachelor” dhe janë diplomuar 57 prej tyre si dhe 37 studentë të programit profesional “Specialist i hetimit të krimin” nga të cilët janë diplomuar 37.

- Përfundoi kursi XVII-të dhe filloi kursi i XVIII-të i shkollimit bazë policor në Kolegjin Profesional të Formimit Policor,.
- Ndjekin kursin e XVIII-të të shkollimit bazë policor në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, 397 kursantë.
- Është zhvilluar dhe përfunduar projekti kërkimor “Ecuria në karrierë për kursantët që kanë përfunduar studimet në Kolegjin Profesional të Formimit Policor si dhe për studentët që kanë përfunduar studimet Bachelor dhe specialistë për hetimin e krimit në F.S.H”, fokusi në periudhën 2006-2022.” i cili u finalizuar në studimin e thelluar me të njëjtin titull.
- Realizimi i projekti kërkimor dhe studimit përkatës me temë “Krimi dhe siguria kibernetike në Shqipëri, i cili po finalizohet më një studim të thelluar në këtë fushë..
- U zhvillua Konferenca e IX-të Shkenore Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë “Krim i she siguria kibernetike në Shqipëri”.
- Janë botuar numrat 29, 30, 31 dhe 32 të Revistës “Policimi dhe Siguria”.
- U përgatit dhe u botua libri për Akreditimin Institucional të Akademisë së Sigurisë.
- Është përgatitur për botim dhe është botuar Libri i Konferencës së Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit.

Gjithsesi, edhe pse kemi pasur arritje në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë gjatë vitit 2023, janë konstatuar edhe mangësi apo veshitësi, për të cilat personeli i Akademisë së Sigurisë është i vetëdijshëm. Ne i kemi identifikuar ato dhe nëpërmjet programit të vitit 2024, do të përpqemi t'i kapërcejmë e të arrijmë rezultate të reja, sidomos në krijimin e kapaciteteve të qëndrueshme dhe krijimin e një imazhi të ri të përfutuesve të shkollimeve e të trajnimeve, për rolin dhe funksionin e tyre në proceset trajnuese.

II. BAZA KU MBËSHETJET PROGRAMI

Në hartimin e programit të Akademisë së Sigurisë për vitin 2024, janë marrë në konsideratë:

1. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 881 date 28. 10. 2020, “Për dhënien e statusit të veçantë Akademisë së Sigurisë, si institucion i vetëm publik i Arsimit të Lartë në fushën e Rendit e të Sigurisë”, i ndryshuar;
4. Prioritetet e punës së Ministrisë së Brendshme për vitin 2024;
5. Programi i Punës i DPPSH për vitin 2024;
6. Programi i Shkollimeve dhe Trajnimeve të Policisë së Shtetit për vitin 2024, i miratuara me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
7. Programi vjetor i trajnimeve të Agjesive ligjzbatuese për vitin 2024, miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;
8. Urdhri i Ministrit të Arsimit dhe Sporteve, me nr. 458, datë 27.07.2018, “Për riorganizimin e Programit të Ciklit të Parë të Studimit “Bachelor”, në “Siguri dhe Hetim”, në Akademinë e Sigurisë;

9. Statuti i Akademisë së Sigurisë, miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë të Brendshëm dhe Ministrisë të Arsimit dhe Sporteve Nr. 130, datë 10.03.2023;
10. Rregullore e Policisë së Shtetit, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 16.09.2015, e ndryshuar;
11. Urdhri i Ministrisë të Brendshëm nr. 47, datë 14.04.2023, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”;
12. Vendim i Senatit të Akademisë së Sigurisë Nr.77 datë 02.05.2023 “Për miratimin e Rregullores së Akademisë së Sigurisë”;
13. Rregulloret e njësisve kryesore dhe të strukturave të tjera vartëse të Akademisë së Sigurisë në përputhje me Statutin dhe strukturën e re;

III. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT QË DO TË REALIZOHEN GJATË VITIT 2024

Akademia e Sigurisë synon që nëpërmjet prioritetëve, objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara më poshtë të rrisë standardet dhe cilësinë e mësimdhënies duke synuar të përmirësojë procedurat e funksionimit të saj, rekrutimit të stafit, duke rritur cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve njerëzore dhe programeve arsimore, konkretisht:

Prioriteti i parë:

“Arsimim cilësor i strukturave të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese përgjatë vitit 2024”

Objektivat:

- a) Rritja e njohurive profesionale të punonjësve të strukturave të sigurisë publike nëpërmjet shkollimit, specializimit dhe trajnimit të vazhduar të të gjitha niveleve.
- b) Rritja e standarteve të kurrikulave dhe programeve mësimore nëpërmjet vlerësimit dhe rishikimit periodik të tyre.

Prioriteti i dytë:

“Harmonizimi i kuadrit nënligjor dhe administrativ në përputhje me standardet e BE-së, si dhe shkëmbimi i eksperiencave në fushën e arsimimit me vendet e BE-së”

Objektivat:

- a) Përshtatja e kuadrit nënligjor dhe administrativ në përputhje me standardet e BE-së.

- b) Forcimi i kapaciteteve të Akademisë së Sigurisë, duke përmirësuar nivelin e përgatitjes së stafit administrativ dhe akademik, intensifikuar shkëmbimet akademike, kapacitetet projektshkruese dhe projektshkruese në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, sipas modelit të Akademisë së Policisë Italisë.
- c) Përmirësimi i standardeve dhe kriterëve përkatëse të rekrutimit të personelit akademik dhe mësimdhënës.

Prioriteti i tretë:

“Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës për punë kërkimore – shkencore, për rritjen e cilësisë së shërbimeve në Akademinë e Sigurisë dhe në të gjitha strukturat e vartësisë së saj”

Objektivat:

- a) Thellimi i edukimit policor nëpërmjet hulumtimit të aplikuar dhe kërkimit shkencor.
- b) Përmirësimi i infrastrukturës për punë kërkimore shkencore.

Prioriteti katërt:

“Rritja e standardeve akademike të mësimdhënies, nëpërmjet përmirësimit të programeve mësimore që zhvillohen në Akademinë e Sigurisë”

Objektivat:

- a) Ndjekja dhe përpunimi deri në përfundimin në afat të deyrave të lënë mbi procesin e akreditimit të Kolegjit Profesional të Formimit Policor në shoqatën IADLEST (USA).
- b) Përditësimi i vazhdueshëm i programit “Bachelor dhe rishikimi i programit të shkollimit bazë policor “Patrullë e Përgjithshme”, në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Për të siguruar një performancë të lartë në të gjitha nivelet dhe strukturat vartëse, Akademia e Sigurisë, do të realizojë prioritetet, objektivat dhe aktivitetet si më poshtë:

1. PRIORITETI I PARË:**Arsimimi cilësor i strukturave të Policisë së Shtetit dhe Agjencive të tjera ligjzbatuese përgjatë vitit akademik 2023-2024.****A. OBJEKTIVI:**

Rritja e njohurive profesionale të punonjësve të strukturave të sigurisë publike, nëpërmjet shkollimit, specializimit dhe trajnimit të vazhduar të të gjitha niveleve.

Përfitime të pritshme

- Rritje të performances së punës të punonjësve të institucioneve përfutuese në AS.
- Përgjegjësi për punën e bërë.

Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Zhvillimi i procesit mësimor sipas Programit të Studimeve të Ciklit të Parë "Bachelor", në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit, në vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025, me vitin e parë, të dytë dhe të tretë.	Janar – Dhjetor 2024	F.S.H
2.	Zhvillimi i programit të studimeve profesionale "Specialist i hetimit të krimin", me shtetas të cilët kanë përfunduar dy ciklet e studimeve universitare.	Janar – Dhjetor 2024	F.S.H
3.	Miratimi i programit të Ciklit të dytë "Master shkencor" në fushën e Sigurisë dhe Hetimit dhe paraqitja e tij në Senatën e AS-së për miratim, si dhe miratimi i programeve dhe leksioneve për lëndët që do të zhvillohen në këtë program.	Janar 2024	F.S.H
4.	Zhvillimi i programit të Ciklit të Dytë të Studimeve "Master Shkencor", në fushën e Sigurisë dhe Hetimit, sipas kërkesave të Policisë së Shtetit dhe agjencive të tjera ligjzbatuese.	Gjatë vitit Akademik 2024-2025	F.S.H
5.	Zhvillimi i trajtimeve për ecurinë në karrierë të punonjësve të Policisë së Shtetit, gradat "Komisar", "Kryekomisar" dhe "Drejtnes i Parë", sipas planifikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.	Gjatë vitit 2024	F.S.H




6	Ndjekja e Trajnimit në terren, "Patrullë e Përgjithshme", për kursin e XVIII.	Janar - Shkurt 2024	K.P.F.P
7	Përmbylla e shkollimit bazë policor "Patrullë e Përgjithshme", për kursin e XVIII dhe certifikimi i tyre.	Shkurt 2024	K.P.F.P
8	Zhvillimi i shkollimit bazë policor "Patrullë e Përgjithshme", për kursin e XIX dhe XX	Gjatë vitit 2024-2025	K.P.F.P
9.	Ndjekja e Programit Vjetor të Trajnimit te vitit 2024, për Policinë e Shtetit dhe për Agjencitë Ligjzbatuese.	Gjatë vitit 2024	D.K.S.C F.S.H K.P.F.P Q.T.T.O
	Ndjekja dhe realizimi deyrave për vazhdimin e kalendarit te bashkëpunimit të "Binjakëzimit të Akademisë së Policisë me Akademinë Italiane të Policisë";	Gjatë vitit 2024	K.P.F.P
	Hartimi i një kalendarit shkëmbimi kursantesh/instrukturësh me shkollat e Policisë Italiane që formojne dhe trajnojne policë të rolit bazë;	Gjatë vitit 2024	K.P.F.P
	Shqyrtimi dhe marrja e programeve/planeve didaktike mësimore të shkollave të Policisë Italiane, për ti implementuar në kurrikulat dhe në programet mësimore të Kolegjit Profesional të Formimit Policor.	Gjatë vitit 2024	K.P.F.P
10.	Rifreskimi i përbërjes së Këshillave të studentëve, të Këshillit të Etikës, mbrojtësit të studentëve dhe njohja e studentëve me rolin e këtyre Këshillave.	Janar 2024	FSH & KPFP

B. OBJEKTIVI :

Rritja e standarteve të kurrikulave dhe programeve mësimore nëpërmjet vlerësimit dhe rishikimit periodik të tyre.

Përfitime të prishme.

- *Vihen në funksion dhe në efijencë të plotë të gjitha strukturat e Akademisë së Sigurisë, në dobi të produktit që Akademia nxjerr në terren, punonjës policie të përgatitur shumë mirë teorikisht dhe praktikisht, për t'ju përgjigjur të gjitha sfidave që ka përpara shoqëria.*

Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Në vijimësi të rishikimit të strukturës së AS-së, do të bëhet rishikimi i kurrikulave, programeve mësimore, shtrijës programore të mirëstudiar me tendencë të shtrijës gjithëvjetore me përllogaritje të standardizuar e cilësore sipas modeleve të akademive europiane të sigurisë e policimit.	 Gjatë vitit 2024	FSH KPPF DKSC
2.	Do të kontrollohet e monitorohet procesi mësimdhënës së pedagogëve dhe instruktorëve, në të gjitha programet dhe trajnimet.	Gjatë vitit 2024 	Njësitë Kryesore D.K.S.C N.I.S.B.C
3.	Do të kryhen anketimet periodike me studentët, si dhe do të zhvillohen anketime me strukturat vendore të policisë, me qëllim marrjen e feedback-ut të tyre rreth efektivitetit dhe efikasitetit të procesit mësimor, si dhe me praktikën e përditshme të policimit.	Ne fund të cdo semestri 	Njësitë kryesore D.K.S.C
4.	Do të hartohen pyetësorë dhe zhvillohen anketime nëpërmjet formularëve të vlerësimit, sipas eksperiencës së vendeve të BE-së, për të gjitha proceset e shkollimit, kurseve dhe specializimet, me qëllim të nxjerrjes së problemeve e mangësive, të mësimdhënësve, metodave dhe kurikulave të përdorura, etj.	Në perfundim të cdo kursi	Njësitë kryesore D.K.S.C
5.	Do të kontrollohen e vlerësohen të gjitha formularët e anketimi të vlerësimit të plotësuar nga kursantët, të çdo kursi që zhvillohet, me qëllim evidentimin e problematikave për produkt vendimmarrje.	Në vazhdim gjatë vitit 2024	Njësitë kryesore D.K.S.C

2. PRIORITETI I DYTË:

Harmonizimi i kuadrit nënligjor dhe administrativ në përputhje me standardet e BE-së, si dhe shkëmbimi i eksperiencave në fushën e arsimit me vendet e BE-së.

A. OBJEKTIVI:

Përshatja e kuadrit nënligjor dhe administrativ në përputhje me standardet e BE-së.

Përfitimet e pritshme:

- *Nga realizimi i këtij objekti, konsolidohet kuadri nënligjor, administrativ dhe organizativ i Akademisë së Sigurisë, përshatur me standardet e vendeve të BE-së.*
- *Përmbyshje të detyrave e procedurave funksionale për çdo funksion.*

Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Dhënie mendimesh në drejtim të arsimit në fushën e sigurisë dhe vënienë në dispozicion të Grupit të Punës, ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në kuadër të hartimit të Ligjit të të Policisë së Shtetit.	Deri në miratimin e ligjit të ri	Drejtes të njësive kryesore dhe strukturave të A.S
2.	Dhënie mendimesh dhe vënienë në dispozicion të Grupit të Punës, ngritur pranë Ministrisë së Brendshme, në kuadër të përmirësimit të Vendimit nr. 881, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për dhënie të statusit të vecantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të tij”, i ndryshuar.	Deri në miratimin e ndryshimeve në VKM nr. 881, datë 28.10.2020	Drejtes të njësive kryesore dhe strukturave të A.S
3.	Pjesëmarrje me grupe pune për diskutime e propozimeve për ndryshime strukturore në përputhje me strategjinë zhvillimore si dhe vizionin, në kuadër të ndryshimeve të pritshme strukturore në Akademinë e Sigurisë.	Janar 2024.	Drejtes të njësive kryesore dhe strukturave të A.S
4.	Përmirësimi i akteve që normojnë punën e Akademisë së Sigurisë, në përputhje me ndryshimet që mund të ndodhin në ligjin e Policisë së Shtetit, nr. 108 / 2014 apo miratimin e një ligji të ri si dhe Vendimin nr. 881, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për dhënie të statusit të vecantë Akademisë së Sigurisë, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e rendit e sigurisë publike, si dhe organizimin e funksionimit të tij”, i ndryshuar.	Gjatë vitit 2024	Drejtes të njësive kryesore dhe strukturave të A.S

B. Forcimi i kapaciteteve të Akademisë së Sigurisë, duke përmirësuar nivelin e përgatitjes së stafit administrativ dhe akademik, intensifikuar shkëmbimet akademike, kapacitetet projektshkruese dhe projektshkruese në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, sipas modelit të Akademisë së Policisë Italisë.

Përfitimet e pritshme:

- Shëndritimi i Akademisë së Sigurisë, në qendër të vetme të formimit profesional, trajnimit dhe kualifikimit të të gjithë punonjësve të policisë, strukturave të policisë gjyqësore pjesë e ekzekutivit dhe e shërbyemeve të tjera të sigurisë sipas modelit të Akademisë së Policisë Italisë.
- Arritja e objektivave për të krijuar një trupë policore të aftë për t'ju përgjigjur kërkesave në rritje të nivelit profesional mësimdhënës dhe sfidave të rendit dhe të sigurisë publike në Shqipëri.

<p>1. Në zbatim të anagazhimeve të marra, në deklaratën e mirëkuptimit, nënshkruar nga palët Policia e Shtetit të Italisë dhe Policia e Shtetit të Shqipërisë, do të vijojë puna, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me Akademinë e Policisë Italiene për krijimin e një modeli formues, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) përmirësim të procedurave respektive të rekrutimit të personelit, duke i kushtuar vëmendje testeve psikologjike; ✓ b) shkëmbimin e materialeve dhe planeve mësimore lidhur me modulët e formimit bazë dhe ato të specializuara; ✓ c) shkëmbim të praktikave të mira dhe përvojave në organizimin e aktiviteteve didaktike dhe të kornizës së përhershme të shkollave të policisë; ✓ d) dërgimit të instruktorëve në rolin e vëzhguesve pranë instituteve formuese respektive; ✓ e) planifikimit dhe vënies në jetë të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese, duke përfshirë këtu periudha stazhi dhe vizita studimi; ✓ f) konsulencë, ndihmesë në përgatitjen e planeve mësimore dhe në formimin e instruktorëve; ✓ g) shkëmbimin e personelit akademik për të favorizuar cilësinë e formimit; ✓ h) shkëmbimin e punonjësve të policisë për frekuentimin e kurseve respektive formuese të specializuara; ✓ i) zhvillimin e projekteve kërkimore të përbashkëta dhe organizimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore si seminare, konferenca dhe çdo event tjetër ku ka interes të përbashkët. ✓ 	<p>Gjatë vitit 2024</p>	<p>FSH & KPPF</p>
---	-------------------------	-----------------------

2.	Rifreskime e miratime të programeve ekzistuese apo të reja për trajnime të specializuara/avancuara apo për funksione të veçanta sipas planit te trajnimeve në Policinë e Shtetit.	Shtator 2024	FSH
3.	Shqyrtim e vlerësim të programeve mësimore të hartuara në varësi të kërkesave për trajnim në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.	Shtator 2024	FSH
<p>C. OBJEKTIVI: Përmirësimi i standardeve dhe kriterëve përkatëse të rekrutimit të personelit akademik dhe mësimdhënës.</p>			
<p>Përfitimet e pritshme: Në realizim të këtij objektiivi, priret që të përfitohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Standardizimi i aktivitetit të brendshëm të AS i adresuar qartë në objektiva dhe qëllime. - <i>Struktura dhe personeli i Akademisë së Sigurisë do të maksimizojë efikasitetin dhe rezultatet për rritjen e kapaciteteve të tij profesionale.</i> 			
Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Do të rishikohen kriteret e pranimit të stafit akademik dhe atij mësimdhënës sipas standardeve që rrjedhin nga ligji i arsimit të lartë dhe kërkimi shkencor në Republikën e Shqipërisë, krahasuar me ato të BE-së.	Gjatë vitit 2024	F.S.H K.P.F.P S.B.NJ QKSHP
2.	Do punohet për dixhitalizimin e dosjeve të personelit të stafit të Akademisë së Sigurisë, në funksion të përzgjedhjes dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e mësimdhënies..	Maj 2024	Sektori i Burimeve Njerëzore
3.	Hartimi i listës së stafit të jashtëm mësimdhënës, per vitin akademik 2024-2025, mbi bazën e propozimeve të ardhura nga departamentet dhe dërgimi për miratim në Senatit Akademik të Akademisë së Sigurisë.	Deri më 20.09.2024	FSH dhe Senatit Akademik

4.	Në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe Akademinë e vendeve të tjera me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi, do të zhvillohet trajnime për rritjen e kapaciteteve në fushën e metodologjisë së mësimdhënies dhe vlerësimit të studentëve / kursantëve.	Gjatë vitit 2024	F.S.H
5.	Do të bëhet promovimi dhe informimi i nxënësve maturan të dhe grupeve të tjera të interesit me programet dhe kurrikulat që ofron Akademia e Sigurisë, me qëllim nxitjen e interesit të tyre për t' u bërë pjesë e strukturave të sigurisë.	Shkurt – Prill 2024	Grupi punës D.K.S.C & Strukturat vendore të P.SH
3. PRIORITETI I TRETË Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës për punë kërkimore – shkencore, për rritjen e cilësisë së shërbimeve në Akademinë e Sigurisë dhe në të gjitha strukturat e vartësisë së saj.			
A. OBJEKTIVI: Thellimi i edukimit policor nëpërmjet hulumtimit të aplikuar dhe kërkimit shkencor.			
Përfitimet e pritshme:			
<ul style="list-style-type: none"> - <i>Nxitja e veprimtarive të punonjësve të institucioneve ligjzbatuese, në thellimin e njohurive, për kërkime shkencore.</i> - <i>Shkëmbim të eksperiencave për çështjet e rendit e të sigurisë.</i> - <i>Pervoje në menaxhimin e situatave dhe incidenteve.</i> - <i>Njohje e ndërveprim, me studiues e hulumtues të fushave të ndryshme të sigurisë.</i> 			
Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Angazhimi i stafit akademik për kryerjen e veprimtarive kërkimore – shkencore bazë ose të zbatuara: studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, në funksion të veprimtarisë së Policisë së Shetit dhe sigurisë së vendit me Qendrën Kërkimore Shkencore apo me të tjera institucione kërkimore.	Gjatë vitit 2024	Njësitë kryesore Q.K.SH.P
2.	Pjesëmarrje individuale në konferenca, seminare, ëorkshop-e, organizuar nga qendra kërkimore, universitete homologe brenda dhe jashtë vendit.	Gjatë vitit 2024	Njësitë kryesore

			Q.K.SH.P
3.	Do të rritet kontributi, me artikuj shkencorë në Revistën “Policimi dhe Siguria” dhe organe shkencore të tjera brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet botimit të numrave periodikë të kësaj reviste.	Gjatë vitit 2024	Njësitë kryesore Q.K.SH
4.	Përpunim dhe hedhje të materialeve që pasqyrojnë aktivitetin e Akademisë së Sigurisë në ëbfaqen online dhe rrjetet sociale.	Çdo javë	QKSHHP
5.	Përfundimi i projektit kërkimor dhe e studimit të thelluar “Mbi krimin dhe Sigurinë Kibermetike në Shqipëri”.	3-mujori I, 2024	QKSHHP
6.	Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit do të përcaktohet tematika për konferencën shkencore të radhës..	3-mujori I, 2024	QKSHHP
7.	Do të realizohet Konferenca e X Shkencore e AS,sipas me tematikës së përcaktuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit	3-mujori IV, 2024	QKSHHP
8.	Përgatitja dhe publikimi i një Albumi të ri për Akademinë e Sigurisë.	3-mujori II, 2024	QKSHHP Grupi i punës
9.	Bazuar në eksperiencën e deritanishme, vijimi i punës për mundësimin e marrjes së Projekteve nga AKKSHI si dhe nga organizma të Bashkimit Europian, në interes të Akademisë së Sigurisë e të misionit dhe vizionit të saj për ta shndëruar IAL të arsimit policor në llder rajonal për kërkimin shkencor dhe mësimdhënien.	Gjatë vitit 2024	Njësitë kryesore dhe strukturat e tjera të AS.
10.	Mbështetja e gjithë aktiviteteve me rastin e ditëve të hapura të Policisë së Shtetit, në pritjen dhe shoqërimin e komunitetit si dhe në gjithë detyrimet institucionale të QKSHHP-së në kuadër të 111 vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit (13 janar 2024).	6 deri 13 Janar 2024	QKSHHP & Njësitë kryesore dhe

			strukturat e tjera të AS.
11.	Përmbyshja e rekomandimeve që rrjedhin nga vendimi nr.07. datë 27.01.2023, të lëna nga bordi i akreditimit institucional të ASCAL-it	Shkurt 2024	Njësitë kryesore dhe strukturat e tjera të AS.
12.	Organizim të një Konference Shkencore Kombëtare, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë të planifikuar në avancë, sipas hapave të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Hartim dhe shpërndarje e thirrjes për pjesëmarrje në konferencë; ✓ Komunikim i vazhdueshëm me aplikantë për pjesëmarrje në konferencë; ✓ Hartimi i Agjendës së konferencës; ✓ Hartimi i listës së kumtuesve dhe të fuarve në konferencë; ✓ Hartimi i dokumentacionit të nevojshëm për organizimin dhe zhvillimin e konferencës. Pjesëmarrje me punim shkencor të stafit akademik në këtë konferencë.	Maj 2024	FSH
B. OBJEKTIVI: Përmirësimi i infrastrukturës për punë kërkimore shkencore			
Nr	Aktiviteti	Afati	Kush e kryen
1.	Plotësimi me bazë logjistike për ushtrimin e veprimtarisë së botimeve në Akademinë e Sigurisë.	Gjatë vitit 2024	FSH & QKSH & KPFP
2.	Mbikqyrje dhe vlerësim të infrastrukturës për punë, projekte, kërkime shkencore dhe botime në fushën e policimit, kriminalitetit dhe sigurisë.	Gjatë vitit 2024	FSH & QKSH & KPFP

3.	Rishikimi i studimit për ndërtimin e kabineteve sipas lëndëve mësimore që zhvillohen në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit dhe për riformatimin e kabineteve ekzistuese, në bazë të nevojave të Departamenteve në FSH.	Gjatë vitit 2024	FSH
4.	Do të punohet për krijimin e një klase të dedikuar vetëm për shërbimin ndaj të tretëve si dhe për shtimin e të ardhurave të ligjshme nga veprimtaria e mësimdhënies së stafit të Drejtorisë së Certifikimeve dhe shërbimeve ndaj të tretëve.	6 majori I, 2024	QTT0
5.	Sipas kalendarit të miratuar do të zhvillohen 10 kurse të trajnimit, ku do të trajnohen 266 kursante. Konkreisht kurset do të jenë për Policine Bashkitake, në fushën e qarkullimit rrugor, motociklistët, zjarfikësit etj	Gjatë vitit 2024	QTT0
6.	Do fillojë puna për ndërtimin e një bibliotekë digjitale, e cila do të ketë libra elektronike. Kjo bibliotekë do të pasurojë fondin tonë të bibliotekës me një numër të lartë titujsh të rinj. Ky fond elektronik do të jetë kryesisht në gjuhë të huaj, ku pjesa më e madhe e librave do të jenë në anglisht. Në këtë kuadër, pjesë e saj do të jetë ndërtimi i një bibliotekë digjitale të fushës, pra profesionale për aktivitetin e policisë, me tituj librash dhe materiale të tjera kërkimore, që do të jenë po ashtu në pjesën më të madhe në anglisht.	3 majori I, 2024	QKSHP
7.	Trajnimi i stafit të Bibliotekës së AS-së nga specialistët e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, për aktivitetin që ato kryejnë, pasi nuk ka pasur trajnime të tilla asnjëherë për punonjëset tona.	Gjatë vitit 2024	QKSHP
8.	Fillimi i punës për dixhitalizimin e bibliotekës së Akademisë së Sigurisë, me qëllim sjelljen me afër stafit akademik, kërkimor shkencor dhe studentëve dhe kursantëve të AS-së.	6 majori I, 2024	QKSHP
9.	Realizimi i një analize të detajuar për gjendjen e Muzeut të Policisë së Shtetit që gjendet në Akademinë e Sigurisë. Qëllimi kryesor do të jetë hartimi i një relacioni, duke e argumentuar nevojën dhe mundësinë e kthimit të tij në një Muze Kombëtar të Policisë së Shtetit	Shkurt 2024	QKSHP

PRIORITETI I KATERT
Rritja e standarteve akademike të mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të programeve mësimore që zhvillohen në Akademinë e Sigurisë.

A. OBJEKTIVI:
 Ndjekja dhe përpunimi deri në përfundimin në afat të detyrave të lënë mbi procesin e akreditimit të Kolegjit Profesional të Formimit Policor në shoqatën IADLEST (USA)”

Përfitimet e pritshme:

- *Akademia e Sigurisë synon që nëpërmjet akreditimit të rrisë standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, duke synuar të përmirësojë procedurat e funksionimit të saj, rekrutimit të stafit, duke rritur cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve njerëzore dhe programeve arsimore, etj.*

<p>1. Ndjekja e procesit deri në përmbyshjen e plotë të dokumentacionit të kërkuar në aplikim për akreditimin e Kolegjit Profesional të Formimit Policor në shoqatën IADLEST (USA)”</p>	Deri ne përmbyllje te procesit	K.P.F.P
<p>2. Vazhdimi i komunikimit me të gjithë formatet zyrtare dhe elektronike me përfaqësues të Shoqatës “IADLEST” - (“International Association of Directors of Law Enforcement”), nga ana e grupeve të punës të Kolegjit Profesional të Formimit Policor.</p>	Deri ne përmbyllje te procesit	K.P.F.P

B. OBJEKTIVI

Përditësimi i vazhdueshëm i programit “Bachelor dhe rishikimi i programit të shkollimit bazë policor “Patrullë e Përgjithshme”, në përpunje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Përfitimet e pritshme:

- *Përgatitja e punonjësve të punonjësve të grades nënkomisar dhe të rolit bazë me njohuri të thelluara për gëshjet e rendit e të sigurisë, me qëllim që të fitojnë përvojë në menaxhimin e situatave dhe zgjidhjen e incidenteve.*

<p>1. Përditësimi i vazhdueshëm i programit “Bachelor”, duke pasqyruar ndryshimet e vazhdueshme që pëson legjislatiioni dhe aktet nënligjore dhe administrative, që mund të ndodhin gjatë vitit akademik 2023 – 2024 dhe 2024-2025.</p>	Shtator 2024	FSH
---	--------------	-----

<p>2. Rritja e standardeve të kurrikulave dhe programeve mësimore të Kolegjit Profesional të Formimit Policor nëpërmjet vlerësimit dhe rishikimit periodik të tyre.</p>	<p>Gjatë vitit 2024</p>	<p>K.P.F.P</p>		
<p>Legjenda:</p> <table border="1"> <tr> <td data-bbox="877 228 1236 1097"> <ol style="list-style-type: none"> 1. M.B 2. P.SH 3. A.S 4. F.S.H 5. K.P.F.P 6. Q.K.SH.P 7. Q.T.T.O 8. D.K.S.C 9. N.J.S.B.C 10. S.B.NJ 11. D.M.N </td> <td data-bbox="877 1097 1236 2004"> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Brendshme 2. Policia e Shtetit 3. Akademia e Sigurisë 4. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit 5. Kolegji Profesional i Formimit Policor 6. Qendra Kërkimore Shkencore dhe Projekteve 7. Qendra e Trajnimeve Taktike e Operacionale 8. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë 9. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 10. Sektori i Burimeve Njerëzore 11. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare </td> </tr> </table>			<ol style="list-style-type: none"> 1. M.B 2. P.SH 3. A.S 4. F.S.H 5. K.P.F.P 6. Q.K.SH.P 7. Q.T.T.O 8. D.K.S.C 9. N.J.S.B.C 10. S.B.NJ 11. D.M.N 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Brendshme 2. Policia e Shtetit 3. Akademia e Sigurisë 4. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit 5. Kolegji Profesional i Formimit Policor 6. Qendra Kërkimore Shkencore dhe Projekteve 7. Qendra e Trajnimeve Taktike e Operacionale 8. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë 9. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 10. Sektori i Burimeve Njerëzore 11. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare
<ol style="list-style-type: none"> 1. M.B 2. P.SH 3. A.S 4. F.S.H 5. K.P.F.P 6. Q.K.SH.P 7. Q.T.T.O 8. D.K.S.C 9. N.J.S.B.C 10. S.B.NJ 11. D.M.N 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ministria e Brendshme 2. Policia e Shtetit 3. Akademia e Sigurisë 4. Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit 5. Kolegji Profesional i Formimit Policor 6. Qendra Kërkimore Shkencore dhe Projekteve 7. Qendra e Trajnimeve Taktike e Operacionale 8. Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë 9. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë 10. Sektori i Burimeve Njerëzore 11. Departamenti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare 			

Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore dhe Projekteve

Drejtes i Parë Prof. Assoc. Dr. Xhavit SHALA

Dakan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit

Drejtes i Parë Xhevdahir Karaj

Drejtor i Drejtorisë së Kurrikulave dhe S.C.

Drejtes Parë Gentjan Shehaj

Drejtor i Kolegjit Profesional të Formimit Policor

Drejtes Mitat Tola

Shefi i Qendrës Trajnimeve Taktike Operac.

Drejtes Mehdi Canga